

**RELACION  
PËR  
PROJEKTLIGJIN  
“PËR CENSIN E BUJQËSISË”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i projektligjit është krijimi i bazës ligjore të konsoliduar për kryerjen e Censit të Bujqësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Censi i Bujqësisë do të kontribuojë në sigurimin e të dhënave bazë të qëndrueshme në kohë, në përcaktimin e tipologjisë së fermës dhe madhësisë ekonomike të saj, krijimin e regjistrit statistikor të njësive ekonomike bujqësore dhe përgjithësimin e rezultateve të arritura në nivel rajonal dhe kombëtar bazuar në kriteret metodike të rekomanduara nga Eurostat.

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë:

- a) të sigurohet informacion i përgjithshëm dhe i hollësishëm për të gjitha njësitë ekonomike bujqësore, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- b) të ofrohen të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe vënien në zbatim të politikave të përgjithshme të zhvillimit ekonomik bujqësor në Republikën e Shqipërisë;
- c) të krijohet regjistri statistikor i njësive ekonomike bujqësore.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKË**

Projektligji është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të vitit 2025, për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Projektligji rrjedh si angazhim i ndërmarrë nga qeveria shqiptare për përmirësimin e treguesve statistikorë, zyrtarë, të prodhuar nga sistemi kombëtar statistikor, dhe rritjen e imazhit të INSTAT-it e besueshmërinë e përdoruesve në

statistikat zyrtare, duke e strukturuar atë në një institucion profesionalisht të pavarur (Programi i qeverisë 2013, “Statistikat”).

Ndërkohë, ligji është i domosdoshëm për të siguruar kryerjen e aktivitetit “Censi i bujqësisë”, parashikuar në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026, miratuar me Ligjin Nr.30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026”.

Në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2024– 2026, është parashikuar harmonizimi i legjislacionit për Censin e Bujqësisë në përputhje të pjesshme me rregulloren Evropiane (BE) 2018/1091 “Statistikat e Integruara të Fermës” në katërmujorin e I, të vitit 2024.

Kryerja e Censit të Bujqësisë vjen edhe si përmbushje e rekomandimeve periodike të Progres-Raporteve të BE për Shqipërinë, për Kapitullin 18 “Statistikat”

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKT-AKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.**

Nevoja për hartimin e këtij projektligji erdhi si rezultat i domosdoshmërisë së rregullimit të kuadrit ligjor për kryerjen e aktivitetit “Censi i bujqësisë”.

Projektligji është në harmoni me *acquis* të BE-së dhe vendos zbatimin e standardeve të BE-së, duke përcaktuar terminologjinë statistikore në linjë me ato të përdorura nga Eurostat.

Ky projektligj do të sjellë përparësi kryesisht duke mundësuar:

- a) përputhshmërinë me terminologjinë dhe përkufizimet e legjislacionit të Bashkimit Evropian;
- b) harmonizimin me ligjin nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”;
- c) përshtatjen e njësive mbështetëse të nivelit vendor sipas përcaktimeve të reja nga reforma administrative dhe territoriale;
- ç) ngritjen e regjistrit statistikor të njësive ekonomike bujqësore;
- d) përgjithësimin e rezultateve të arritura në nivel rajonal dhe kombëtar bazuar në kriteret metodike të rekomanduara nga Eurostat.

Projektligji ka efekt të pritshme prodhimin e treguesve statistikorë të plotë, të cilët mundësojnë panoramë të përditësuar dhe hartimin e politikave.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është hartuar në bazë të neneve 78 dhe 83 pika 1, të Kushtetutës.

Projektligji përaftron pjesërisht Rregulloren Evropiane (BE) 2018/1091, “Statistikat e Integruara të Fermës”, i cili do të mundësojë përafrimin e mëtejshëm të statistikave të bujqësisë dhe blegtorisë me kërkesat e rregulloreve përkatëse, si dhe rritjen e indikatorëve statistikorë.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Ky projektligj synon përafrimin e pjesshëm me Rregulloren (BE) nr. 2018/1091 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 18 korrik 2018 “Mbi statistikën e integruar të fermës dhe shfuqizimin e Rregullos (KE) nr.1166/2008 dhe (BE) nr 1337/2011”, numri CELEX 32018R1091, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 200/1, datë 07.08.2018, faqe 1–29.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji i propozuar përmban 33 nene gjithsej, të strukturuar në 5 krerë, përmbajtja e të cilave parashtrohet në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon:

**Kreu I**, dispozita të përgjithshme rregullonë objektin, qëllimin, fushën e zbatimit, përkufizimet dhe të dhënat e burimet e tyre. Gjithashtu, ky kre rregullon dhe periudhën e referencës, cilësinë statistikore, mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin dhe rezultatet e censit të bujqësisë.

**Neni 1** përcakton objektin e projektligjit, i cili ka të bëjë me Censin e Bujqësisë.

**Neni 2** përcakton qëllimin e censit, i cili ka të bëjë, kryesisht, me ofrimin e të dhënave të nevojshme për planifikimin dhe vënien në zbatim të politikave të përgjithshme të zhvillimit ekonomik bujqësor në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 3** përcakton fushën e zbatimit që përfshin njësité ekonomike bujqësore, që tregtojnë, njësité ekonomike, që mbulojnë vetëm nevojat e tyre familjare, si edhe të gjitha njësité ekonomike bujqësore, që ushtrojnë veprimtari tregtare me kohë të pjesshme.

**Neni 4**, përkufizime, përmban terminologjinë statistikore, të rishikuar sipas rregullores së BE-së mbi statistikën e integruara të fermës. Gjithashtu, ai përmban më tepër përkufizime, në mënyrë që të shmangen paqartësitë dhe keqkuptimet.

**Neni 5** parashikon përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore.

**Neni 6**, parashikon burimet e të dhënave me kusht që informacioni të lejojë prodhimin e statistikave që plotësojnë kërkesat e cilësisë statistikore si p.sh. të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave, anketat statistikore të zhvilluara për prodhimin e statistikave zyrtare, të dhënat administrative bujqësore që disponojnë institucionet publike, burime të tjera dhe metoda të tjera alternative.

**Neni 7**, të dhënat e mbledhura, përcakton kategoritë e të dhënave që do të mbledhen vetëm për qëllime statistikore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statistikën zyrtare, si edhe sipas standardeve dhe rekomandimeve të Eurostatit dhe të Kombeve të Bashkuara për censet e bujqësisë.

**Neni 8** parashikon se pyetësi i censit i cili është miratuar nga INSTAT-i, dhe përmban pyetjet e detyrueshme dhe kërkesat e nevojshme për mbledhjen e informacionit për prodhimin e statistikave zyrtare.

**Neni 9** parashikon detyrimin ligjor të drejtuesve të njësive ekonomike bujqësore për t'u përgjigjur, dhe për të dhënë informacion të plotë, korrekt e të vërtetë, sipas pyetësorit.

**Neni 10** përcakton organet zbatuese dhe mbështetëse, detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre organeve përcaktohen në kreun II të këtij projektligji.

**Neni 11** parashikon vendosjen e ditës së censit dhe të periudhës së mbledhjes së të dhënave në planin vjetor për zbatimin e programit 5-vjeçar të statistikave zyrtare.

**Neni 12** përcakton periudhën e referencës për mbledhjen e informacionit duke iu referuar situatës gjatë një afati kohor ose date të caktuar.

**Neni 13** parashikon marrjen e masave të nevojshme për të siguruar cilësinë e të dhënave dhe metadatave të transmetuara në mënyrë që kriteret e cilësisë

statistikore të jenë në përputhje me parimet statistikore të përcaktuara në legjislacionin për statistikat zyrtare.

**Neni 14** i projektligjit, përcakton në mënyrë të hollësishme detyrimin për të respektuar konfidencialitetin e informacionit të mbledhur, në përputhje me parashikimet e ligjit të statistikave zyrtare si dhe të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Sigurimi ligjor i konfidencialitetit statistikor do të mundësojë dhënien e informacionit në mënyrë të saktë e objektive dhe, për rrjedhojë, prodhimin e statistikave zyrtare të besueshme.

Për të garantuar konfidencialitetin, projektligji ngarkon INSTAT-in të marrë masat e duhura teknike dhe organizative për trajtimin e të dhënave nga momenti i mbledhjes deri në arkivimin e tyre.

**Neni 15** i projektligjit, përcakton që rezultatet e censit duhet të trajtohen si pasuri e përbashkët e shoqërisë shqiptare dhe duhet të aksesohen në mënyrë të barabartë nga të gjithë përdoruesit. Gjithashtu, nëpërmjet këtij neni, INSTAT-i ngarkohet të publikojë të dhënat, duke shmangur çdo mundësi identifikimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, si dhe të japë të drejtën e hyrjes në të dhëna në nivel mikro vetëm për qëllime kërkimore shkencore. INSTAT i dërgon të dhënat e censit Eurostatit brenda 12 muajve nga përfundimi i periudhës së referencës.

**Kreu II** përmban dispozita që rregullojnë punën e organeve të ngarkuara për censin e bujqësisë, përbërjen, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.

**Nga neni 16** deri në nenin 23, të projektligjit, përcaktohen njësitë organizative përgjegjëse për planifikimin, zbatimin dhe mbështetjen e veprimtarisë së censit, ku përfshihen INSTAT-i, Komisioni Qendror i Censit të Bujqësisë dhe komisionet e censit të bujqësisë në nivel bashkie, mënyra e funksionimit të tyre dhe përgjegjësitë. Qëllimi i ngritjes së tyre është për të mbështetur përgatitjen dhe zbatimin e censit të bujqësisë në zonën që ata mbulojnë, duke vënë në dispozicion ambientet dhe burimet që disponojnë.

**Kreu III** përmban dispozita që rregullojnë procedurat e censit të bujqësisë si fushata informuese, personeli dhe ndalimi për mbledhjen e të dhënave të ngjashme.

**Në nenin 24**, përcakton rregullat e fushatës informuese, që fillon 4 javë para ditës së censit dhe përfundon me nxjerrjen e rezultateve.

**Neni 25** i projektligjit, përcakton personelin që do të angazhohet në cens. Sipas këtij neni, në personelin e censit do të përfshihen staf i terrenit (anketues, kontrollorë, mbikëqyrës, specialistë IT, staf i terrenit për hartografinë) si dhe staf tjetër, i cili do të merret me administrimin e procesit, sigurimin e kapaciteteve profesionale, përpunimin dhe publikimin e të dhënave (trajnerë, operatorë, statisticienë, demografë etj.). Për zgjedhjen e personave të duhur, projektligji ngarkon INSTAT-in të përcaktojë kriteret dhe të ngrijë komisione ad-hoc për shqyrtimin e kandidaturave. Duke qenë se MBZHR disponon personel të specializuar në fushën e bujqësisë si dhe janë njohës të mirë të terrenit, projektligji parashikon përfshirjen e punonjësve të agjensive në varësi të ministrisë, kryesisht për të asistuar aktivitetet përgatitore dhe proceset e mbledhjes së të dhënave në terren.

**Neni 26**, ndalimi për mbledhjen e të dhënave të ngjashme, vendos ndalimin që të mblidhen të dhëna për censin nga individë ose organizata të tjera me përjashtim të INSTAT në kuadër të këtij procesi.

**Kreu IV** përmban dispozita që rregullojnë kundërvajtjet administrative, verifikimin dhe ankimimin ndaj tyre.

**Neni 27** përcakton kundërvajtjet administrative, ndërsa neni 28 përcakton procedurën e shqyrtimit të ankesave dhe ngarkon INSTAT-in, për shqyrtimin, verifikimin dhe marrjen e vendimeve për kundërvajtjet administrative të konstatuara, në respektim të dispozitave të këtij ligji dhe ligjit për kundërvajtjet administrative.

**Në nenin 29** parashikohen ankimet pranë Gjykatës Administrative, ndaj vendimeve të INSTAT-it.

**Neni 30**, parashikimet lidhur me financimin e censit të bujqësisë i cili sigurohet nga buxheti i shtetit, përmes fondeve të veçanta të miratuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor të INSTAT-it.

**Neni 31** përcakton nxjerrjen e akteve nënligjore.

**Kreu V**, dispozita përfundimtare, rregullon në nenin 32, shfuqizimin e Ligjit Nr.10201, datë 17.12.2009, "Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore", ndërsa në nenin 33 hyrjen në fuqi sipas rregullit të përgjithshëm 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Për zbatimin e këtij akti ngarkohet Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si mbështetëse për vënien në dispozicion të personelit të censit stafin e specializuar në fushën e bujqësisë që disponojnë agjencitë në varësi të saj.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji u hartua nga INSTAT dhe u dërgua për mendim. Më pas INSTAT në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural reflektuan sugjerimet dhe përmirësuan tekstin.

Në kuadër të procesit të konsultimit publik, projektligji është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftime dhe Konsultime Publike (RENJKP) nga data **30.7.2025** deri më datën **27.8.2025**, ku nga ky proces janë përcjellë sugjerime dhe komente nga 2 grupe interesi, përkatësisht UN Women dhe Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, mbi të cilat është hartuar Raporti Individual i Konsultimit Publik bashkëlidhur dokumenteve shoqëruese të projektligjit, i publikuar në RENJKP dhe gjithashtu janë reflektuar ndryshimet në draftin e ripunuar të projektligjit.

Lidhur me sugjerimet e konsultimit të brendshëm:

**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**, brenda fushës së përgjegjësisë u shpreh parimisht dakord me projektligjin.

**Ministria e Brendshme**, brenda fushës së përgjegjësisë u shpreh parimisht dakord me projektligjin.

**Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor** shprehet parimisht dakord brenda kompetencave.

**Ministri i Shtetit për Marëdhëniet me Parlamentin** u shpreh parimisht dakord dhe pa vërejtje.

**Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit**, brenda fushës së përgjegjësisë u shpreh parimisht dakord me projektligjin.

**Ministria e Mbrojtjes**, shprehet projektligj është jashtë fushës së përgjegjësisë saj dhe sugjeron heqjen e ministrisë së Mbrojtjes nga përbërja e Komisionit Qëndror të Censit të Bujqësisë, parashikuar në nenit 15 të projektligjit.

Lidhur me këtë sugjerim INSTAT shprehet se në censet e mëparshme Ministria e Mbrojtjes ka ndihmuar me mjetet e saj për transportin e materialeve në terrene të vështira. Për rrjedhojë, INSTAT propozon që ministria të vazhdojë të jetë e përfshirë në Komisionin Qëndror të Censit. Pra, përfshirja është logjistike dhe nuk ka detyrime përmbajtësore.

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, shprehet parimisht dakord dhe sugjeron tregues të ndarë sipas gjinisë për aksesin e grave dhe të drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore, si edhe koordinimin e këtij procesi me të gjitha grupet e interesit, nëpërmjet një procesi konsultimi gjithëpërfshirës me grupet e veçanta si: gratë, pakicat kombëtare etj.

Lidhur me këtë sugjerim sqarojmë se parimet e barazisë gjinore janë reflektuar dhe garantuar në projektligj pas përfundimit të procesit të konsultimit publik të realizuar nga MBZHR dhe marrjen në konsideratë të sugjerimeve/komenteve të ardhura nga grupet e interesit në bashkëpunim me INSTAT.

**Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit**, shprehet dakord, duke sugjeruar që në shkronjën “f”, të pikës 2, të nenit 15, të kreut II, emërtimi “ministri përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes”, të zëvendësohet me “ministri përgjegjës për sipërmarrjen”, kjo në përputhje me fushën e veprimtarisë shtetërore të përcaktuar me vendimin nr. 558, datë 4.10.2023, të Këshillit të Ministrave.

Sugjerimi u reflektua në projektligj.

**Ministria e Shtetit dhe Kryenegociatorit**, u shpreh parimisht dakord me vijimin e procedurave të projektligjit.

**Ministria e Drejtësisë, shprehet me komente si vijon:**

1. Në lidhje me komentën e parë ku kërkohet të shpjegohet se si do të vërtetohet besueshmëria për të dhënat që do të ofrohen sipas parashikimeve të shkronjës “b”, të nenit 2, të projektligjit, *sqarojmë se në fund të shkronjës “b” është dhënë detyrimi i zbatimit të parimeve statistikore sipas legjislacionit për statistikat zyrtare. Një ndër këto parime (nenet 4 dhe 5 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, parashikojnë edhe detyrimin e institucioneve prodhuese për sigurimin e besueshmërisë duke përdorur standardet e legjislacionit evropian dhe Eurostatit.*
2. Lidhur me komentën e dytë për përkufizimin e dhënë për termin “vendndodhje”, në pikën 4, të nenit 4, të projektligjit, të shpjegohet nëse njësia ekonomike bujqësore do të ketë dhe seli, në kushtet kur sipas pikës 2, të këtij neni kjo njësi është e vetme, si nga pikëpamja teknike, ashtu edhe ekonomike, e cila drejtohet nga një person i vetëm ose grup personash, që ndërmerr veprimtari ekonomike në bujqësi ose mirëmban tokën bujqësore në gjendje të mirë bujqësore dhe mjedisore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky rekomandim vjen dhe si pasojë e faktit që projektligji nuk përmban një dispozitë konkrete, në të cilën të shpjegohet njësia ekonomike bujqësore.

*Sqarojmë se në kategorinë e Njësive Ekonomike Bujqësore përfshihen edhe individë, grup individësh apo familje të cilat nuk janë të regjistruar administrativisht si sipërmarrës, përkufizimi i termit “Vendndodhje” modifikohet me këtë përmbajtje:*

*“4. “Vendndodhje” është vendbanimi i zotëruesit të njësisë ekonomike bujqësore ose vendndodhja administrative e selisë së njësisë ekonomike bujqësore.”*

3. Në lidhje me komentën e tretë, lidhur me strukturimin e pikës 1, të nenit 6, të projektligjit, duket sikur përveç kategorive kryesore të të dhënave që do të mblidhen gjatë censit do të ketë dhe të tjera. Si rrjedhojë, nëse gjendemi përpara këtij rasti, të specifikohen se cilat do të jenë këto kategori.

*Në pikën 1 të nenit 6, u hoq termi “kryesore”.*

4. Në nenin 8, të projektligjit termi “të vërtetë” të hiqet, në kushtet kur nuk është shpjeguar se në cilën mënyrë mund të vërtetohet që informacioni që do të japin drejtuesit e njësive ekonomike bujqësore, do të jetë i vërtetë.

*Lidhur me sugjermimin Referuar pikës 2 të nenit 26 të projektligjit, INSTAT-it i jepet e drejta e konsultimit të bazave të të dhënave shtetërore për të shqyrtuar vërtetësinë e informacioneve të dhëna. Cilësia dhe realiteti i të dhënave që gjenerohen nga censi varen nga cilësia dhe vërtetësia e informacionit të deklaruar nga individët. Për rrjedhojë, mendojmë që termi “të vërtetë” të mos hiqet nga neni 8.*

5. Në nenin 14, të projektligjit, togfjalëshi “janë një pasuri e përbashkët e të gjithë shoqërisë shqiptare”, të riformulohet, në kushtet kur rezultatet statistikore nuk mund të konsiderohen si “pasuri”, *sqarojmë se komenti u pranua dhe u reflektua në projektligj.*

6. Në pikën 2, të nenit 15, të projektligjit, të përcaktohet numri i anëtarëve që do të jenë pjesë përbërëse e Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë. Ky rekomandim të mbahet në konsideratë dhe për pikën 4, të nenit 19, të projektligjit, sa i përket numrit të Komisionit të Censit të Bujqësisë.

*Sqarojmë se numri i anëtarëve të komisioneve nuk përcaktohet dot për shkak të ndryshimeve të mundshme të strukturës së qeverisë. Po kështu, duke qenë se numri i njësive administrative të bashkisë është i ndryshëm, nuk mund të përcaktohet numri i saktë i anëtarëve në këto komisione. Si rrjedhojë, sugjerimi nuk pranohet.*

7. Sa i përket pikës 2, të nenit 18, të projektligjit, të përcaktohen se cilat do të jenë aktivitetet e tjera të paparashikuara, me qëllim kryerjen e suksesshme të censit të bujqësisë, në kushtet kur parashikimet e një dispozite ligjore duhet të jenë sa më të qarta dhe shteruese. *Sqarojmë se kjo pikë është propozuar për ti garantuar INSTAT-it autoritetin ligjor që ka në lidhje me sigurinë për prodhimin e statistikave zyrtare sipas parimeve statistikore të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”. Për rrjedhojë, sugjerim që pika të qëndrojë siç është propozuar.*

8. Lidhur me komentin mbi detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Censit të Bujqësisë në nivel bashkie, të parashikuara në nenin 20, të projektligjit, të specifikohen dhe konkretizohen, në kushtet kur aktualisht në këtë nen

janë parashikuar vetëm detyra mbështetëse për INSTAT. Gjithashtu, të shpjegohet se përse ky Komision do të vazhdojë të funksionojë deri në një muaj pas përfundimit të procesit të mbledhjes së të dhënave, sipas pikës 2, të këtij neni. *Komisionet janë propozuar të ngrihen dhe të kenë vetëm funksione mbështetëse kryesisht nga pikëpamja logjistike si dhe për t'i vënë në dispozicion INSTAT-it burimet dhe informacionet që disponojnë, për të bërë të mundur mbarëvajtjen e aktiviteteve të censit në terren. Në këto kushte, mendojmë se detyrat funksionale të komisioneve janë shprehur qartë në nenet 19 dhe 20 të projektligjit.*

9. Në lidhje me pikën 5, të nenit 21, të projektligjit, të argumentohet se përse rregullat e detajuara për procedurat e thirrjes, organizimit, zhvillimit të mbledhjes e miratimit të vendimeve të komisioneve të censit, do të miratohen nga drejtori i përgjithshëm i INSTAT.

*Kjo pikë është propozuar duke marrë parasysh eksperiencën e ngjashme në rastin e censit të popullsisë dhe banesave (pika 5 e nenit 17 të Ligjit nr. 140/2020 "Për censin e popullsisë dhe banesave". Duke qenë se në përbërje të këtyre komisioneve janë edhe përfaqësuesit e INSTAT-it si institucioni drejtpërdrejtë përgjegjës për mbarëvajtjen e censit, si dhe përfaqësues të disa institucioneve të tjera, ligjvënësi i ka dhënë titullarit të INSTAT-it autoritetin për të miratuar rregulloren e funksionimit të këtyre komisioneve.*

10. Në nenin 22, të projektligjit, të specifikohet afati konkret brenda të cilit ASHK do të japi në kohë dhe pa pagesë informacionin e kërkuar nga INSTAT. Në lidhje me mospagesën e shërbimit kundrejt ASHK, të mbahen në konsideratë parashikimet e nenit 63 të ligjit nr.111/2018 "Për kadastrën", sipas së cilit "Çdo shërbim kadastral që ofrohet, me përjashtim të rasteve të veçanta, të parashikuara në këtë ligj, tarifohej", si dhe pikës 3, të Kreut II, të vendimit nr.864/2022, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave për procedurën e trajtimit të kërkesave për shërbime kadastrale", sipas së cilit "Trajtimi i kërkesave për shërbime kadastrale bëhet në mënyrë kronologjike, dhe llogaritja e afateve për marrjen e këtyre shërbimeve fillon nga e nesërmja e ditës së konfirmimit bankar të pagesës së tarifës së shërbimit. Përjashtohen këtu: a) Shërbimet kadastrale që gjenerohen në mënyrë automatike nga baza shtetërore e të dhënave kadastrale (ALBSCAD); b) Shërbimet që ofrohen për institucionet shtetërore me paspagim, sipas vendimit nr. 389, datë

13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar; c) Shërbimet për të cilat dokumentacioni shoqërues përcillet nëpërmjet shërbimit postar”.

*ASHK hiqet nga parashikimet e nenit 22 dhe pasqyrohet në pikën 3 të nenit 5 të projektligjit. Përsa i takon pagesës, mbështetur në pikën 1 të nenit 33 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”, institucionet publike janë të detyruar t’i japin INSTAT-it të drejtën e hyrjes pa pagesë në regjistrat apo skedarët e të dhënave që disponojnë. Gjithashtu, mbështetur në pikën 1 të nenit 40, ky ligj prevalon ndaj çdo kuadri tjetër ligjor për rastet e transmetimit të të dhënave administrative.*

11. Në nenin 25, të projektligjit, termi “staf” të zëvendësohet me termin “personel”, *sugjerimi u reflektua në projektligj.*

12. Në lidhje me pikën 2, të nenit 27, të projektligjit, rekomandojmë me qëllim të një hetimi administrativ sa më gjithëpërfshirës, INSTAT të konsultojë gjithmonë bazat e të dhënave shtetërore në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kontekst, të specifikohet se cili do të jetë “legjislacioni në fuqi”.

*Mbështetur në pikën 1 të nenit 33 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”, institucionet publike janë të detyruar t’i japin INSTAT-it të drejtën e hyrjes pa pagesë në regjistrat apo skedarët e të dhënave që disponojnë. Për këtë arsye, pranohet sugjerimi dhe kjo pikë saktësohet me togjalishtin “në përputhje me legjislacionin për statistikën zyrtare”.*

13. Sa i përket afatit të ankimit të parashikuar në pikën 1, të nenit 29, të projektligjit, rekomandojmë rishikimin e tij, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, ku sipas nenit 132, parashikohet se “Ankimi administrativ ndaj aktit administrativ duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për nxjerrjen ose refuzimin e nxjerrjes së aktit administrative. *Sugjerimi u reflektua në projektligj.*

14. Lidhur me sugjerimin për shmangien për aq sa është e mundur të përdorimit të termave deklarativë “duhet të”, foljeve modale si “mund” dhe lidhëzave “dhe/ose”, në përputhje me parashikimet e neneve 28 dhe 30, të Udhëzimit nr.6/2022, të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e

metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”, *ky sugjerim u reflektua në projektligj.*

15. Lidhur me sugjerimin që projektligji të paraqitet në Këshillin e Ministrave në bashkëpropozim me ministrinë e bujqësisë. Në relacionin e projektligjit të argumentohet nevoja për zbatimin e rregullores së BE nr. 2018/1091 në këtë moment kohor, në të cilin vendi ynë nuk është ende anëtar i BE. Vlerësohet e nevojshme kryerja e një analize mbi pasojat e mundshme të dërgimit të këtyre të dhënave në EUROSTAT dhe të publikimit të tyre. Gjithashtu të argumentohet, pse nuk përdoren të dhënat e mbledhura tashmë nga ministria e bujqësisë, por duhet të kryhet një cens i ri, i cili ka një kosto të konsiderueshme për buxhetin e shtetit. Në përfundim të jepen shpjegimet përkatëse, se si do të financohet censi dhe mbi zbatimin në praktik të parashikimeve të projektligjit.

*Lidhur me këtë sugjerim sqarojmë se, Censi është një aktivitet statistikor gjithëpërfshirës i cili zhvillohet në frekuencë 10-vjeçare dhe ka për qëllim të japë të dhëna mbi bujqësinë, blegtorinë etj. në një moment të caktuar. Të dhënat që mbledh nuk kanë karakter administrativ dhe publikohen vetëm të agreguara. Ky ushtrim zhvillohet pothuajse nga të gjitha vendet e botës dhe në të njëjtën kohë, në mënyrë që të mundësohen seritë e duhura kohore dhe krahasueshmëria. Kombet e Bashkuara dhe Eurostatit kanë dhënë rekomandime përkatëse për kryerjen e censeve, duke unifikuar metodologjitë dhe standardet statistikore të këtij raundi. Kryerja e Censit të Bujqësisë është një kërkesë që vjen nga rekomandimet e BE-së për Shqipërinë, për Kapitulin 18 “Statistikat”, pjesë e Grup-Kapitujve të parë (Cluster 1) dhe Kapitullit 11, “Bujqësia dhe zhvillimi rural”. Komisioni Evropian në Progres Raportin për Shqipërinë publikuar në nëntor 2025, evidenton nevojën e kryerjes së censit në vitin 2026, angazhim ky që përmbushet duke krijuar bazën ligjore të konsoliduar nëpërmjet këtij projektligji.*

**Agjencia Shtetërore e Kadastrës**, brenda fushës së përgjegjësisë shprehen si vijon:

“Agjencia Shtetërore e Kadastrës e ushtron veprimtarinë e saj në zbatim të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Konkretisht në nenin 63 të ligjit parashikohet se: “Çdo shërbim kadastral

që ofrohet me përjashtim të rasteve të veçanta të parashikuara në këtë ligj, tarifohet”. Referuar sa më sipër, bëjmë me dije se parashikimet e bëra në nenin 22 të projektligjit “Për qëllimet e censit të bujqësore Agjencia Shtetërore e Kadastrës i jep në kohë dhe pa pagesë INSTAT-it, listën e plotë të pronarëve të tokës, sipërfaqen në pronësi dhe adresat e vendndodhjes së tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”, në raport me mënyrën e ofrimit të informacionit nga ASHK bien ndesh me parashikimet e ligjit nr.111/2018, pasi informacioni i kërkuar përbën shërbim kadastral në kuptim të ligjit të mësipërm.” Në vijim sugjerojmë që përmbajtja e dispozitës së sipërcituar të ketë përmbajtjen sa vijon: 22. “Për qëllimet e censit të bujqësisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës i jep INSTAT-it shërbimin e kërkuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”. Gjithashtu, në vijim të arsyetimit të sipërcituar bëjmë me dije se, lista e institucioneve që kanë akses në kadastrën digjitale dhe rregullat e marrjes së informacionit në bazën shtetërore të të dhënave kadastrale (ALBSCAD) janë parashikuar në nenin 28 të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, prandaj edhe parashikimet e bëra në këtë drejtim në raport me ASHK duhet të jenë në përputhje me këto parashikime.

*Sqarojmë se në tekstin e projektligjit nuk janë kryer ndryshime për shkak të sugjerimit të ASHK-së. Kjo bazuar në pikën 1 të nenit 33 të Ligjit Nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”, institucionet publike janë të detyruar t’i japin INSTAT-it të drejtën e hyrjes pa pagesë në regjistrat apo skedarët e të dhënave që disponojnë. Gjithashtu, mbështetur në pikën 1 të nenit 40, për shkak të interesit publik që përcjell, ligji prevalon ndaj çdo kuadri tjetër ligjor për rastet e transmetimit të të dhënave administrative. Nga ana tjetër, parashikimet e Ligjit Nr.111/2018 nuk afekton me akt nënligjor, por me akt me të njëjtën hierarki po krijohet një përjashtim.*

**Ministria e Financave**, në këndvështrimin buxhetor konstaton se projektakti shoqërohet me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit në masën 890.9 milionë lekë, si rezultat shprehen se:

1. Kostoja e zhvillimit të censit të bujqësisë është rreth 890.9 milion lekë, nga të cilat INSTAT ka të planifikuar 268.7 milion lekë brenda buxhetit të tij për vitin 2024. Referuar kostimit sipas zërave të paraqitur nga INSTAT si dhe relacionit shpjegues, kërkojmë që të paraqitet një analizë

më e detajuar financiare, shoqëruar me argumenta shteruese në lidhje me zërat e shpenzimeve të paraqitura, duke argumentuar cilat janë referencat e marra për përllogaritjen e kostos për zëra si për shembull dieta për misione/udhëtime (105 euro për person), studime/kërkime/asistencë teknike (rreth 1 milion euro), udhëtime ndërkombëtare për rritje terreni (55 mijë euro) etj.

*Planifikimi i shpenzimeve për Censin e Bujqësisë, referuar Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2026-2028, paraqitet në tabelën shpjeguese sipas zërave si më poshtë.*

*Shpenzime për Censin e Bujqësisë në 000 lekë*

| <i>Llog. Ekonomike</i> | <i>Kapitull</i> | <i>Përshkrimi</i>                              | <i>Fonde viti 2026</i> | <i>Fonde viti 2027</i> | <i>Fonde viti 2027</i> |
|------------------------|-----------------|------------------------------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|
| 600                    | 1               | Paga                                           | 143,245                | 8,084                  | 0                      |
| 601                    | 1               | Kontribute sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 23,922                 | 1,350                  | 0                      |
| 602                    | 1               | Mallra dhe shërbime të tjera                   | 629,216                | 56,717                 | 32,233                 |
| 231                    | 1               | Investime                                      | 35,906                 |                        |                        |
|                        |                 | <b>Totali</b>                                  | <b>832,289</b>         | <b>66,151</b>          | <b>32,233</b>          |

*Në përputhje me planifikimin buxhetor, shpenzimet gjithsej të parashikuara për vitet 2026–2028, për Censin e Njësive Ekonomike Bujqësore, që përfshijnë si shpenzimet korrente ashtu edhe ato të investimeve nga buxheti i shtetit, vlerësohen në shumën prej 930,673 mijë lekësh.*

*Treguesit kryesorë të projektbuxhetit janë si më poshtë:*

- *Detyrimet për pagesën e pagave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të cilat paraqiten në vlerën 167,167 mijë lekë për vitin 2026 dhe 9,434 mijë lekë për vitin 2027.*

*Këtu përfshihen shpenzimet për paga dhe kontribute të punonjësve me kontratë pune, si kontrollorë, specialistë të TI-së në mbështetje të procesit të grumbullimit të të dhënave në terren, specialistë GIS, si dhe staf mbështetës për burime njerëzore, financë dhe buxhet, juristë dhe specialistë prokurimi.*

*Shërbimet e udhëtimit janë llogaritur në zbatim të V.K.M. nr. 997, datë 10.12.2010, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", të ndryshuar.*

• *Shpenzimet për mallra dhe shërbime, të cilat për vitin 2026 paraqiten në vlerën 629,216 mijë lekë, përbëhen nga:*

- 1. Shpenzime për anketues me kontratë shërbimi, në vlerën 345,804 mijë lekë.  
Janë parashikuar rreth 3,400 anketues, të cilët do të jenë të angazhuar për një periudhë dy mujore, tetor – nëntor 2026.*
- 2. Shërbime udhëtimi dhe monitorimi, në vlerën 27,081 mijë lekë, të destinuara për mbështetjen e procesit të trajnimeve dhe monitorimeve gjatë kryerjes së vrojtimit në terren.*
- 3. Shpenzime për marrje me qira të automjeteve të nevojshme për procesin e monitorimit në terren, në shumën 8,459 mijë lekë.*
- 4. Shpenzime për zyra me qira, që përfshijnë marrjen me qira të ambienteve për zhvillimin e trajnimeve dhe funksionimin e stafit gjatë periudhës së zhvillimit në terren të Censit. Ky zë llogaritet në vlerën 27,763 mijë lekë.*
- 5. Shpenzime për shërbime vizibiliteti dhe të tjera, të llogaritura në 92,795 mijë lekë, që përfshijnë fushatën publicitare, organizimin e konferencave, publikimet, asistencën teknike etj.*
- 6. Shpenzime të tjera, të parashikuara kryesisht për internet cloud, karburant për transport gjatë periudhës së Censit dhe për ekspertë të jashtëm, në vlerën 46,322 mijë lekë.*
- 7. Kosto indirekte (deri në 7% të kostove të drejtpërdrejta), në vlerën 51,541 mijë lekë.*
- 8. Rezervë emergjence (deri në 5% të kostove të drejtpërdrejta), në vlerën 29,452 mijë lekë.*

• *Shpenzimet për shërbime për vitin 2027 paraqiten në vlerën 56,717 mijë lekë, dhe përbëhen nga:*

- 1. Shpenzime të tjera, kryesisht për ekspertë të jashtëm, në vlerën 50,162 mijë lekë;*
- 2. Kosto indirekte, në vlerën 4,172 mijë lekë;*
- 3. Rezervë emergjence, në vlerën 2,384 mijë lekë.*

• *Shpenzimet për shërbime për vitin 2028 paraqiten në vlerën 32,233 mijë lekë, dhe përbëhen nga:*

1. Shpenzime të tjera, kryesisht për ekspertë të jashtëm, në vlerën 29,039 mijë lekë;
2. Kosto indirekte, në vlerën 2,033 mijë lekë;
3. Rezervë emergjence, në vlerën 1,162 mijë lekë.

*Investimet përfshijnë blerjen e serverëve, storage dhe rrjetit për përpunimin e sasive të mëdha të të dhënave, si dhe për komunikimin e pajisjeve të terrenit me serverët qendrorë, në vlerën 35,906 mijë lekë.*

*Këto investime sigurojnë një infrastrukturë moderne dhe të qëndrueshme për përpunimin dhe publikimin e statistikave.*

*Infrastruktura Cloud mundëson ruajtjen dhe përpunimin e sigurt të të dhënave të Censit të Bujqësisë, duke ofruar akses të shpejtë dhe të besueshëm.*

*Kartat SIM janë të domosdoshme për mbledhjen e të dhënave në terren në kohë reale, duke rritur cilësinë dhe efikasitetin e procesit.*

*Këto nevoja buxhetore janë thelbësore për funksionimin efikas dhe të pandërprerë të institucionit, duke mbështetur aktivitetet kryesore operacionale dhe strategjike.*

*Investimi në shërbimet dhe pajisjet e përmendura siguron cilësi, siguri dhe efikasitet në mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave.*

2. Nisur nga fakti se INSTAT së fundmi ka ngritur infrastrukturën që u përdor për censin e popullsisë dhe faktit që mundësitë buxhetore aktuale janë të kufizuara, kërkojmë të analizohet nga ana juaj mundësia e reduktimit të kostos financiare të censit të bujqësisë, duke shqyrtuar mundësinë e shfrytëzimit të infrastrukturës së censit të fundit të zhvilluar nga ana juaj.

*INSTAT ka marrë masa për reduktimin e ndjeshëm të censit të bujqësisë duke përdorur infrastrukturën e mbledhjes së të dhënave, të cilat përfshijnë tabletat që do të përfshihen në fazën e mbledhjes së të dhënave dhe përgatitjen e aplikacionit për instalim në tablet. Për këtë arsye, për censin e bujqësisë nuk janë parashikuar blerje tableta të rinj për anketuesit.*

3. Së fundmi, konstatohet se qëllimi dhe përbërja, detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe funksionimi dhe mbledhjet e komisioneve të censit të bujqësisë që do të ngrihen në çdo bashki janë të përcaktuara në nenet 19, 20 dhe 21 të këtij projektligji. Lidhur me efektet financiare, në relacionin shoqërues nuk ka të dhëna nëse ky projektligj do të ketë efekte në buxhetet e bashkive, apo do të përballohet tërësisht nga buxheti qendror. Për sa më sipër, nga këndvështrimi i financave vendore, kërkojmë të përcaktohet qartë nëse ka efekt financiar për bashkitë zbatimi i këtij projektligji, dhe në rast se ka, sa mund të jetë ky efekt.

*Lidhur me këtë pikë sqarojmë se, duke u mbështetur në praktikën e censit të popullsisë, nuk është parashikuar masë shpërblimi për anëtarët e komisioneve pasi INSTAT është i mendimit se përfaqësimi në komision lidhet me natyrën e punës së anëtarëve të komisioneve.*

Në vijim projektligji do të dërgohet për bashkërendim në ministritë e linjës.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Shpenzimet për kryerjen e censit përballohen nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të donatorëve që kanë shprehur interes të mbështesin financiarisht kryerjen e censit të bujqësisë.

*Planifikimi i shpenzimeve për Censin e Bujqësisë, referuar Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2026-2028, paraqitet në tabelën shpjeguese sipas zërave si më poshtë.*

*Shpenzime për Censin e Bujqësisë në 000 lekë*

| <i>Llog. Ekonomike</i> | <i>Kapitull</i> | <i>Përshkrimi</i>                              | <i>Fonde viti 2026</i> | <i>Fonde viti 2027</i> | <i>Fonde viti 2027</i> |
|------------------------|-----------------|------------------------------------------------|------------------------|------------------------|------------------------|
| 600                    | 1               | Paga                                           | 143,245                | 8,084                  | 0                      |
| 601                    | 1               | Kontribute sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 23,922                 | 1,350                  | 0                      |
| 602                    | 1               | Mallra dhe shërbime të tjera                   | 629,216                | 56,717                 | 32,233                 |
| 231                    | 1               | Investime                                      | 35,906                 |                        |                        |
|                        |                 | <b>Totali</b>                                  | <b>832,289</b>         | <b>66,151</b>          | <b>32,233</b>          |

*Në përputhje me planifikimin buxhetor, shpenzimet gjithsej të parashikuara për vitet 2026–2028, për Censin e Njësive Ekonomike Bujqësore, që përfshijnë si shpenzimet korrente ashtu edhe ato të investimeve nga buxheti i shtetit, vlerësohen në shumën prej 930,673 mijë lekësh.*

*Treguesit kryesorë të projektbuxhetit janë si më poshtë:*

- Detyrimet për pagesën e pagave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të cilat paraqiten në vlerën 167,167 mijë lekë për vitin 2026 dhe 9,434 mijë lekë për vitin 2027.*

*Këtu përfshihen shpenzimet për paga dhe kontribute të punonjësve me kontratë pune, si kontrollorë, specialistë të TI-së në mbështetje të procesit të grumbullimit të të dhënave në terren, specialistë GIS, si dhe staf mbështetës për burime njerëzore, financë dhe buxhet, juristë dhe specialistë prokurimi.*

*Shërbimet e udhëtimit janë llogaritur në zbatim të V.K.M. nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.*

- Shpenzimet për mallra dhe shërbime, të cilat për vitin 2026 paraqiten në vlerën 629,216 mijë lekë, përbëhen nga:*

*9. Shpenzime për anketues me kontratë shërbimi, në vlerën 345,804 mijë lekë.*

*Janë parashikuar rreth 3,400 anketues, të cilët do të jenë të angazhuar për një periudhë dy mujore, tetor – nëntor 2026.*

10. Shërbime udhëtimi dhe monitorimi, në vlerën 27,081 mijë lekë, të destinuara për mbështetjen e procesit të trajnimeve dhe monitorimeve gjatë kryerjes së vërtetimit në terren.
  11. Shpenzime për marrje me qira të automjeteve të nevojshme për procesin e monitorimit në terren, në shumën 8,459 mijë lekë.
  12. Shpenzime për zyra me qira, që përfshijnë marrjen me qira të ambienteve për zhvillimin e trajnimeve dhe funksionimin e stafit gjatë periudhës së zhvillimit në terren të Censit. Ky zë llogaritet në vlerën 27,763 mijë lekë.
  13. Shpenzime për shërbime vizibiliteti dhe të tjera, të llogaritura në 92,795 mijë lekë, që përfshijnë fushatën publicitare, organizimin e konferencave, publikimet, asistencën teknike etj.
  14. Shpenzime të tjera, të parashikuara kryesisht për internet cloud, karburant për transport gjatë periudhës së Censit dhe për ekspertë të jashtëm, në vlerën 46,322 mijë lekë.
  15. Kosto indirekte (deri në 7% të kostove të drejtpërdrejta), në vlerën 51,541 mijë lekë.
  16. Rezervë emergjence (deri në 5% të kostove të drejtpërdrejta), në vlerën 29,452 mijë lekë.
- Shpenzimet për shërbime për vitin 2027 paraqiten në vlerën 56,717 mijë lekë, dhe përbëhen nga:
    4. Shpenzime të tjera, kryesisht për ekspertë të jashtëm, në vlerën 50,162 mijë lekë;
    5. Kosto indirekte, në vlerën 4,172 mijë lekë;
    6. Rezervë emergjence, në vlerën 2,384 mijë lekë.
  - Shpenzimet për shërbime për vitin 2028 paraqiten në vlerën 32,233 mijë lekë, dhe përbëhen nga:
    4. Shpenzime të tjera, kryesisht për ekspertë të jashtëm, në vlerën 29,039 mijë lekë;
    5. Kosto indirekte, në vlerën 2,033 mijë lekë;
    6. Rezervë emergjence, në vlerën 1,162 mijë lekë.
- Investimet përfshijnë blerjen e serverëve, storage dhe rrjetit për përpunimin e sasive të mëdha të të dhënave, si dhe për komunikimin e pajisjeve të terrenit me serverët qendrorë, në vlerën 35,906 mijë lekë.

*Këto investime sigurojnë një infrastrukturë moderne dhe të qëndrueshme për përpunimin dhe publikimin e statistikave.*

*Infrastruktura Cloud mundëson ruajtjen dhe përpunimin e sigurt të të dhënave të Censit të Bujqësisë, duke ofruar akses të shpejtë dhe të besueshëm.*

*Kartat SIM janë të domosdoshme për mbledhjen e të dhënave në terren në kohë reale, duke rritur cilësinë dhe efikasitetin e procesit.*

*Këto nevoja buxhetore janë thelbësore për funksionimin efikas dhe të pandërprerë të institucionit, duke mbështetur aktivitetet kryesore operationale dhe strategjike.*

*Investimi në shërbimet dhe pajisjet e përmendura siguron cilësi, siguri dhe efikasitet në mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave.*

MINISTËR

Andis Salla

